

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

Të dashur bashkëqytetarë,

Siç e patë, erdhi, foli 45 minuta, nuk tha asgjë dhe iku. Cilido prej jush që sot priste përgjigje dhe transparencë për çështjen nga Edi Rama, mori thjesht një lumë metaforash, sharjesh ndaj opozitës dhe asnjë sqarim për këtë vendim të drejtësisë amerikane. Kur ngre akuza për kundërshtarët politikë, e tha vetë, flet si prokuror, ndërsa ne të tjerëve, kur ka akuzë për të nga drejtësia amerikane, na thotë: "Prisni drejtësinë amerikane". Që të flasë drejtësia amerikane, ai zotëria do të duhej të kishte bërë atë që bëri si shou në nisje të seancës, të ishte atje një deputet i thjeshtë i këtij Kuvendi dhe jo Kryeministër, sepse, për sa kohë është Kryeministër, fshihet pas imunitetit diplomatik që i jep Konventa e Vjenës. Për t'u bërë shqiptarëve transparencën e nevojshme dhe faktin që nuk ka kryer asnjë krim, do të duhej të ishte larguar nga karrigia e Kryeministrit dhe të lejonte drejtësinë amerikane dhe atë shqiptare t'i hetonin 14 takimet, që i pranoi këtu se i ka kryer, por nuk na tha se ç'ishte gjithë kjo dashuri e madhe e shefit të FBI-së me Edi Ramën. Pse nuk kishte të njëjtën dashuri ky me Kryeministrin e Maqedonisë, me Kryeministrin e Malit të Zi, me Kryeministrin e Kosovës?! Çfarë e lidhte në këtë marrëdhënie speciale, siç e ka quajtur dhe e ka pranuar vetë, këtë zyrtar të lartë të FBI-së me një kryeministër të një vendi të vogël, siç është Shqipëria?! Në fakt, prej më shumë se 1 muaji, opinionimi publik shqiptar dhe ndërkombëtar është njohur me një nga dosjet më të pista të FBI-së: korrupsionin nga ana e Kryeministrit në detyrë të Shqipërisë, Edi Rama, të një prej zyrtarëve më të lartë të FBI-së, shefit të zyrës së kundërzbulimit të FBI-së në Nju Jork, Charles McGonigal. Deri tani është e njohur botërisht se vetëm 2 njerëz kanë guxuar ta korrumpojnë zyrtarin e lartë të FBI-së: i pari është oligarku rus, miku i Putinit, Deripaska dhe i dyti është kryeministri i një vendi anëtar të NATO-s, Edi Rama, të dy me të njëjtin qëllim: të përdorin privatisht fuqinë e FBI-së kundër rivalëve, njëri në biznes dhe tjetri në politikë. Pra, ish-shefi i FBI-së është sot në gjykim dhe pritet të dënohet për akuza që shkojnë deri në 20 vjet burg për shkak të raportit privat, të fshehtë dhe korruptiv që ka ndërtuar me dy individë: me oligarkun rus, njeriun e afërt të Putinit dhe Kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, bashkë me 2 bashkëpunëtorë në këtë aferë: shqiptarë amerikanin Agron Neza dhe këshilltarin privat të Edi Ramës, me kredenciale qeveritare, Dorian Duçka.

Nëse prisnit që sot Edi Rama të jepte shpjegime si Kryeministër, besoj se pas fjalimit të tij e kuptuat se në këtë çështje u soll fiks ashtu siç ne e kemi paralajmëruar para një muaji, si i pandehur, pra kishte vendosur të heshte në lidhje me akuzat. Kjo, sepse si Kryeministër ka kaluar çdo vijë të kuqe. Ai është përfshirë në një nga aferat më të rënda në këta 32 vjet. Është më e rënda, sepse ka brenda pasoja të shumëfishta: ka brenda korrupsion, ka brenda para të pista, ka brenda intrigën, ka brenda trafikun e influencave, ka brenda abuzimin me pushtetin për të goditur kundërshtarin me mjete jodemokratike, ka brenda cenimin e sigurisë kombëtare, ka brenda cenimin e marrëdhënieve me partnerin tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka brenda turpërimin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, ka brenda tentativën e Edi Ramës për të diskredituar kredibilitetin e institucioneve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, duke dëmtuar rëndë imazhin e mikut tonë të madh strategjik dhe aleatit tonë në NATO, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Shkurt, është një pisllek kriminal, të cilin vetëm Edi Rama mund ta kryejë. Vetëm në kushtet e një pislleku kriminal mund të ndodhë që kryeministri i një vendi nëpër restorante, në dreka e darka, në parkingjet e restoranteve të

organizojë, të nxisë dhe të ushtrojë ndikim të paligjshëm përmes trafikut të influencave financiare e politike, goditjen e partisë kundërshtare dhe lidhjet të saj. Për çfarë e bën këtë?! Që ta përdorë hetimin e organizuar nga miku i tij i korruptuar si të vetmin argument kundër opozitës së vendit të tij dhe ta përdorë rastin për politikë dite, duke harruar se e dëmton vendin dhe bën pis Shqipërinë. Vetëm në një pisllek kriminal ndodh që Agron Neza, dëshmitari i rremë i Edi Ramës në hetimin e nxitur prej tij dhe të nisur nga miku i tij i korruptuar, McGonigal, paguan të paktën 225 mijë dollarë në dorë dhe këshilltari i Edi Ramës, këshilltari privat i tij, paguan shpenzimet mijëradollarëshe për të gjetur dëshmitarë dhe për t'i intervistuar nëpër Europë, duke marrë edhe informacion drejtpërdrejt nga zyra e Kryeministrit për këtë çështje. Për çfarë e bën Agron Neza këtë gjë? Për të goditur Partinë Demokratike. A përfitonte Agron Neza ndonjë gjë nga kjo?! Jo, ai që përfitonte ishte vetëm Edi Rama. Në planin e tij kriminal, Edi Rama nuk llogariti një detaj: Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë bahçja e vilës së tij në Surrel. Sistemi i drejtësisë atje nuk është sistemi që kontrollon Edi Rama këtu. SHBA-të nuk janë Shqipëria e rrënuar që ka ndërtuar Edi Rama në këta 10 vjet. Dhe ja ku jemi sot, brenda ditës, nga paditës u shndërrua në të paditur, nga Kryeministër u shndërrua në të pandehur, nga zëdhënës i FBI-së në Tiranë u shndërrua në zëdhënës in e oligarkëve rusë në Tiranë, nga Kryeministri i një vendi anëtar të NATO-s u shndërrua në njeriun që tradhton dhe godet pas shpine mikun dhe aleatin më të madh të vendit tonë në NATO, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Korrupsioni me të paktën 225 mijë dollarë i një zyrtari të lartë të FBI-së për interesa kriminale është një nga ato akte, i cili nuk harrohet dhe nuk mund të falet as në Shqipëri dhe as në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në muajin qershor të vitit 2021, kur Presidenti Biden shpalli se lufta ndaj korrupsionit në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë korrupsionin në Shqipëri, është prioritet i Shteteve të Bashkuara të Amerikës sepse cenon sigurinë kombëtare të SHBA-së, shumëkush habitej sesi ishin të lidhura këto dy çështje, por më 24 janar secili prej nesh e kuptoi që mjaftonte një kryeministër i korruptuar në Shqipëri që të depërtojë dhe të korruptojë një zyrtar të lartë të FBI-së në SHBA, duke vënë seriozisht në rrezik sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mjafton një kryeministër i korruptuar në Shqipëri që interesat ruse apo individë të lidhur me interesa ruse të sillen me detyrën e tyre jo si amerikanë, por si rusë, të sillen me detyrën e tyre jo si njerëz të drejtësisë apo shtetarë, por si mafiozë. Në një rreth të mbyllur korruptiv, ekzaktësisht sikur të ishin një organizatë kriminale, Edi Rama përfitonte nga marrëdhënia me McGonigal-in për hetimin e rremë ndaj opozitës, për ta përdorur, siç e përdori, politikisht në Shqipëri. McGonigal-i përfitonte valixhet me paratë e korrupsionit dhe interesat financiare që paguheshin përmes Agron Nezes, ndërsa ky i fundit përfitonte firmën e Kryeministrit të Shqipërisë dhe të qeverisë shqiptare për interesat e veta financiare në biznes. Në periudhën 2017-2018, sipas vendimit të drejtësisë amerikane, miku i McGonigal-it, shtetasi Agron Neza dhe këshilltari informal me kredenciale qeveritare i Edi Ramës, shtetasi Dorian Duçka, kishin interesa financiare nga vendimmarrja e qeverisë në fushën e licencimit për nxjerrjen e naftës. Këtë nuk e them unë, por e thotë vendimi i drejtësisë amerikane. Këtë e kishte në dorë Edi Rama, që ishte i gatshëm të ofronte gjithçka vetëm që miku i tij i korruptuar në FBI të godiste Partinë Demokratike dhe të kthehej në një armë në duart e pista të Edi Ramës. Dhe kështu ndodhi; në muajt mars-maj 2018, menjëherë pasi ishin dhënë 225 mijë dollarët dhe pasi zyrtari i lartë i FBI-së kishte nisur hetimet që donte Edi Rama kundër opozitës shqiptare, Kryeministri kreu një tjetër akt të paligjshëm dhe korruptiv, kësaj herë me qeverinë e tij, kësaj herë duke përdorur vulën e qeverisë së tij. Në një tender të sajuar për dhënien me koncesion të disa vendburimeve të naftës shpalli fituese ekzaktësisht kompaninë e kërkuar nga miqtë dhe shoqëruesit e McGonigal-it. Pronari i kësaj kompanie, vetëm pak kohë më vonë, bëri aksioner mikun e Edi Ramës në FBI, McGonigal-in dhe bashkëpunëtorin e tij, Agron Nezen, duke ua shitur të gjitha aksionet e kompanisë së tij vetëm për 3 dollarë. Nuk ka rëndësi ligji në këtë rast. Nuk ka rëndësi edhe se dëmi financiar që i bëhej shtetit shqiptar kapte shifrën e 300 milionë

dollarëve. Këtë nuk e them unë, por e thotë edhe një vendim i gjykatave shqiptare, që e evidenton në detaje sesi qeveria e Edi Ramës shkeli ligjin, i shkaktoi shtetit 300 milionë dollarë dëm vetëm e vetëm që miku i korruptuar i Edi Ramës, McGonigal-i, dhe individë të lidhur me të, si Agron Neza, të përfitonin atë që kishin kërkuar pas ndereve të pista që i kishin bërë Edi Ramës në Amerikë. Vetëm në një pisllek kriminal ndodh që Kryeministri i një vendi anëtar të NATO-s, aleat i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të korruptojë një zyrtar të lartë amerikan dhe të vendosë pasuritë e vendit të tij në funksion të korrupsionit të tij. Vetëm në një pisllek kriminal ndodh që, ndërsa përbetohesh për partneritet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për rubla ruse, vetëm 2 javë pasi Departamenti i Thesarit sanksionoi oligarkun rus, mik të Putinit, ti dhe qeveria jote jep një investim strategjik me vlerë 7 milionë euro. Edi Rama e di më mirë se kushdo se, kur organizon një pisllek kriminal, herët a vonë do të vuash edhe pasojat. Ky krim nuk kalohet as me qeshje dhe as me nënqeshje, siç bëri sot Edi Rama. Nuk e kalon me të pavërteta dhe justifikime të trasha këtë që ke bërë në rastin konkret, sepse ke kryer aktin më të rëndë, që nuk ka guxuar askush tjetër në botë ta kryejë: ke korruptuar një zyrtar të lartë amerikan dhe je korruptuar prej tij, ke shndërruar zyrën e Kryeministrit dhe pushtetin që buron prej saj si paradhomë të interesave ruse, të interesave kriminale e korruptive dhe e ke përdorur zyrën e Kryeministrit për të goditur me mjete jodemokratike opozitën e vendit. Sot, si shqiptar, Edi Rama ka vetëm një detyrim: krimin që ka kryer dhe turpin që ka kryer duhet ta mbajë vetëm për vete. Mos ua ngarko këtë mbi shpinë shqiptarëve dhe Shqipërisë! Boll kanë vuajtur shqiptarët dhe Shqipëria nga lidhjet e tua kriminale. Jep dorëheqjen dhe vendosu në dispozicion të drejtësisë amerikane dhe shqiptare! Boll u kape me thonj pas karriges së Kryeministrit! Boll u fshehe pas pushtetit politik në Shqipëri dhe imunitetit diplomatik në SHBA! Ato nuk vlejné përjetësisht dhe ti nuk mund të fshihesh përjetësisht. Faleminderit!